



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Dragash shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Përkthimit dhe Interpretimit
Institucioni	Komuna Dragash
Nr. i Referencës	RN00009213
Kodi	RPC0002956
Data e njoftimit	10.06.2022
Afati për aplikim	01.07.2022 - 08.07.2022

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën e përkthimit;
- Kryen përkthime me shkrim nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, sipas kërkesës dhe nevojës, në mënyrë profesionale, brenda afateve kohore të caktuara, sipas standardeve, dhe prioriteteve; (përkthen seancat e Kuvendit, seancat e komiteteve etj. nga audio në tekst, si dhe harton procesverbalet në dy gjuhët).
- Përkthim konsektiv dhe simultan në dhe për nevojat e Komunës së Dragashit (për të gjitha strukturat përfshirë shkresat dhe aktet zyrtare legjislativore, web faqe, përkthimi në takimet e ndryshme, grupe punues, trajnime, punëtori, konferenca për shtyp, me zyrtarë apo institucione – delegacione, etj.);
- Lekturon, korrekton dhe kontrollon përkthimet, si dhe punë të ndërlidhura që mund të kërkohen;
- Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij, për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushën e përkthimit, duke u kujdesuar që shërbimi të jetë sa më efikas dhe efektiv;
- Bashkëpunon dhe konsultohet me zyrtarët e K. Dragash apo zyrtarë tjerë, për ofrimin të shërbimeve të përkthimit, si dhe bashkë koordinojnë ofrimin e shërbimit;
- Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara dhe përmbushjen e kërkesave;

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar ; Diplomë Universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor).

- Kualifikime të posaçme formale:

.Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës apo ekuivalentë, Certifikata të ndryshme nga lemia e përkthimit.

.Aftësi të shkëlqyera të hartimit të procesverbalit nga audio në tekst, hartimi i procesverbaleve të seancave të kuvendit dhe të komiteteve tjera.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e përkthimeve ;
- Aftësi për përkthim simulant dhe konsektiv shqip-serbisht-shqip;
- Aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës shqipe dhe serbe - niveli i hartimit;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punë profesionale të kryer detyrat e punës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- Shkathshi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point dhe Access)..

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0002616	RN00008852	Zyrtar për Përkthime	Profesional 2	7	Komuna Dragash	Drejtoria per Admin.pune te Përgji. / komuna dragash

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- • Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- • Kopjet e dëshmisë së punësimit
- • Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- • Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- • Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe serbokroate - niveli letrar dhe i hartimit;
- Aftësi për përkthim simultan dhe konsektiv;
- Aftësi për marrjen e vendimeve lidhur me metodat e punës në përputhje me standardet profesionale, pa u konsultuar me zyrtarët e nivelit më të lartë;
- Njohuri për lekturim;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës, koordinim, dhe bashkëpunim;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohja e gjuhës angleze e preferuar (jo obligative);

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

